I nderuar Klient,

Të falenderojmë edhe njëherë që je pjesë e rrugëtimit të lute Albania!

Në vijim të interesimit tënd, më poshtë këtij dokumenti do të gjesh cdo informacion të nevojshëm në lidhje me sigurimin vullnetar të Mbrojtjes së Kredisë.

Sigurimi i Mbrojtjes së Kredisë të mbron në rastin kur për shkak të ngjarjeve të papritura si paaftësia totale nga aksidenti apo humbja e jetës për shkaqe natyrale apo aksidentale, vlera e kredisë së mbetur të mos trashëgohet tek familjaret por të shlyhet nga sigurimi.

Pasi të njihesh plotësisht me informacionin parakontraktor bashkë me kushtet e përgjithshme të sigurimit dhe të biesh dakord me to, lutem jep pëlqimin për pranimin e tyre.

Për çdo informacion te mëtejshëm mos hezito të kontaktosh shërbimin e klientit në numrin 044505060.

Faleminderit,
Ekipi lute Albania

# Sigurimi i Mbrojtjes së Kredisë

## Dokument mbi Informacionin e Produktit të Sigurimit
## Shoqëria e Sigurimit: INSIG Jetë sh.a.

INSIG Jetë

**Paketa: Sigurimi i Mbrojtjes së Kredisë**

INSIG Jete sh.a. është shoqëri sigurimi jete, e licensuar me Vendimin Nr. 04, dt. 08.06.2000 nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, për të ushtruar veprimtarinë për të gjitha klasat e sigurimit të jetës, në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

Ky dokument jep një përmbledhje të informacionit më të rëndësishëm, që lidhet me këtë produkt, por nuk është i personalizuar për ty. Të gjitha detajet që lidhen me informacionin para-kontraktor dhe kontraktor për këtë produkt, janë të disponueshme dhe mund të shkarkohen në faqen zyrtare të internetit iute.al/sigurimi-i-mbrojtjes-se-kredise/ , së bashku me informacionin mbi tarifat e zbatuara për këtë produkt sigurimi. Në momentin që zgjedh të sigurohesh, duke pranuar kushtet e sigurimit dhe kryhet apo autorizohet pagesa e primit të sigurimit, informacioni i mësipërm do të të dërgohet së bashku me certifikatën e sigurimit edhe në rrugë elektronike.

**Çfarë është ky lloj sigurimi?**
Sigurimi i Mbrojtjes së Kredisë është një **produkt vullnetar sigurimi jete**, i cili ofrohet për personat që marrin kredi dhe i mbron ata nga rreziku i pamundësisë së shlyerjes së kredisë, si pasojë e humbjes së jetës apo paaftësisë së përhershme si pasojë e aksidenteve. Në rast të ndodhjes së një prej ngjarjeve të listuara tek seksioni mbulimeve, shoqëria e sigurimit, paguan pjesën e mbetur të detyrimit të kredisë. **Ky produkt nuk përbën detyrim për të marrë kredinë, por është tërësisht në vullnetin e kredimarrësit.**

### Çfarë mbulohet?
- ✓ Humbja e jetës nga shkaqe natyrore
- ✓ Humbja e jetës aksidentale
- ✓ Paaftësi e përhershme e plotë

### Çfarë nuk mbulohet?
- ✗ Pjesëmarrje në veprimtari të paligjshme
- ✗ Pasoja nga konflikte të mëparshme
- ✗ Luftrat, revolucionet
- ✗ Sportet ekstreme
- ✗ Defekte fizike apo mendore paraekzistuese
- ✗ Sëmundje veneriane, SST.

### A ka kufizime në mbulim?
- ! Individë më të rinj se 18 vjeç
- ! Individë mbi 65 vjeç
- ! Individë që kanë nevojë për kujdes të përhershëm
- ! Individë që vuajnë nga alkoolizmi, narkotizmi, sëmundje mendore, paranoia, sindroma organiko-cerebrale.

### Ku je i mbuluar?
**Paaftësi e përhershme e plotë**
✓ Shqipëri

**Humbja e jetës**
✓ Në të gjithë Botën

### Cilat janë detyrimet e tua?
- Të paguash primin e sigurimit, në mënyrë që mbulimi të hyjë në fuqi
- Të lexosh me kujdes informacionin para-kontraktor dhe të japësh dakordësinë për t'u bërë pjesë e kësaj skeme sigurimi, vetëm pasi të jesh bindur që ky sigurim është i përshtatshëm për ty, por në çdo rast përpara se të vijosh me pagesën e primit të sigurimit.
- Të na njoftosh nëse ka ndryshim në rrethanat tuaja, që të bëjnë të papërshtatshëm për të përftuar këtë mbulim.

### Kur dhe si paguaj?
- Primi mund të paguhet njëherësh ose nëpërmjet planit me këste me interes zero, të mundësuar vetëm për klientët kredimarrës të iute
- Primi mund të paguhet nëpërmjet të gjitha mjeteve të njohura të pagesave të ligjshme në Republikën e Shqipërisë. iute nuk pranon pagesa me para në dorë.

### Kur fillon dhe kur mbaron mbulimi me sigurim?
Mbulimi fillon në datën e shënuar në Certifikatën e Sigurimit, e cila përkon me datën e fillimit të kredisë, mbi të cilën lëshohet ky mbulim, me kusht që të jetë paguar primi i sigurimit. Mbulimi përfundon kur:
- Ti anullon mbulimin brenda periudhës së lejuar 14-ditore
- Huaja është shlyer, rifinancuar, apo transferuar.
- Ka ndodhur ngjarja e sigurimit dhe siguruesi i ka paguar përfituesit shumën e dëmshpërblimit.

### Si mund ta anullosh kontratën?
Ti ke të drejtë ta anulosh kontratën brenda 14 ditëve nga lëshimi i certifikatës së sigurimit, që përkon me datën e fillimit të kredisë. Ne do të të rimbursojmë plotësisht primin e paguar, me përjashtim të rasteve kur ka ndodhur ngjarja e sigurimit. Për ta anuluar kontratën, duhet të bësh një njoftim me shkrim në info@iute.al. Në rast se e ke shlyer plotësisht kredinë kontrata do të anullohet automatikisht. Përtej afatit 14-ditor nuk ka rimbursim të primit të sigurimit.

IutePay sh.p.k. regjistruar në Regjistrin Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit me numër unik NUIS M02209002O është e licensuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare për të ushtruar veprimtari ndërmjetësimi në tregun e sigurimit të jetës me Nr. Licence 1922/1, datë 24.11.2023. Nëse ke pyetje dhe dëshiron të mësosh më tepër për produktin mund të kontaktosh në adresën info@iute.al apo nr. Tel: 044505060. Stafi ynë teknik është i gatshëm t'i përgjigjet çdo pyetjeje apo paqartësie që mund të kesh. Ky dokument është në përputhje me nenin 20, paragrafin 9 të Direktivës së Bashkimit Evropian, IDD – për shpërndarjen e sigurimeve dhe bazohet mbi formatin e aprovuar nga EIOPA – Autoriteti Evropian i Sigurimeve dhe Pensioneve Profesionale.

iute

KUSHTET E PËRGJITHSHME PËR SIGURIMIN E JETËS NË GRUP PËR HUAMARRËSIT E "IUTECREDIT ALBANIA"
(SIGURIMI I MBROJTJES SË KREDISË)

1. PERCAKTIME
1.1 Kushtet e Përgjithshme të kontratës për sigurimin e jetës së Debitorit, këtu e në vazhdim do të quhen "*Kushtet e sigurimit*".
1.2 INSIG JETË-sh.a., këtu e në vazhdim do të quhet "*Siguruesi*".
1.3 Personi fizik që janë personalisht përgjegjës për shlyerjen e huasë ndaj Policëmbajtësit këtu e në vazhdim do të quhet "*Debitori*".
1.4 Debitori, individi për jetën e të cilit është lidhur kontrata e sigurimit këtu e në vazhdim do të quhet "*I Siguruari*".
1.5 Personi juridik, Kreditori që në këtë kontratë do të referohet dhe si Policëmbajtësi, që ka lëvruar huanë në bazë të një marrëveshje me të siguruarin dhe përfiton nga kjo kontratë sigurimi, këtu e në vazhdim do të quhet "*Përfituesi*"
1.6 Dokumenti që provon dhe rregullon kontratën e sigurimit, këtu e në vazhdim do të quhet "*Polica e Sigurimit*".
1.7 Me *"Hua"* do të kuptojmë huanë bankare apo ndonjë hua tjetër lëshuar nga ndonjë insitucion kredidhënës.
1.8 Shuma e huasë dhe/ose shënuar në policën e sigurimit, në ditën që lidhet kontrata e sigurimit, këtu e në vazhdim do të quhet "*Shuma e sigurimit*"
1.9 Shuma e parave që i paguhet Siguruesit , për lidhjen e kontratës së sigurimit, këtu e në vazhdim do të quhet "*Prim Sigurimi*".
1.10 Sasia e mjeteve monetare që nevojitet në cdo kohë për të paguar huanë, ashtu sic tregohet në skedulin e caktuar të amortizmit kur lëvrohet kredia duke përjashtuar, pagesa të vonuara të kësteve të kredisë, interesat për këstet e vonuara si dhe komisionet apo shpenzimet e tjera Bankare këtu e në vazhdim do të quhet "*Perfitim i Pagueshëm*".
1.11 Humbja e jetës së të siguruait për shkaqe aksidentale apo natyrore brenda periudhës sigurimit, ndodhja e të cilës sjell detyrimin e Siguruesit për të paguar përfitimin sipas kushteve të sigurimit, këtu e në vazhdim do të quhet "*Ngjarja e sigurimit*".
1.12 Dëmtim trupor i shkaktuar nga mjete të rastit, të dhunshme, të dukshme i cili pavaresisht dhe i pafavorizuar nga ndonje shkak tjetër rezulton në vdekjen e të siguruarit do të quhet "*Aksident*".
1.13 Humbja e jetës së të siguruarit si pasojë e aksidentit brënda periudhës së sigurimit do të quhet *'Humbja aksidentale jetës*"
1.14 Humbja e jetës së të siguruarit brënda periudhës së sigurimit pavarësisht nëse është shkaktuar ose jo nga aksidenti, me përjashtim të rreziqeve të përjashtuara në këtë kontratë sigurimi këtu e më poshtë do të quhet " *Humbja e Jetës*"
1.15 Në rast se i siguruari si rezultat i nje aksidenti humbet totalisht aftësinë e tij për punë në profesionin e tij dhe në cdo profesion tjetër, pas përfundimit të nje periudhe 52 javore nga fillimi i paaftësisë e cila si rezultat i aksidentit rezulton: humbja totale dhe e pariparueshme shikimit në të dy sytë; humbja totale fizik ose funksional e dy ose më shumë gjymtyrëve së bashku; humbja e plotë e shikimit në nje sy dhe humbja e nje gjymtyre së bashku; paraliza e plote ( Humbja ose dëmtimi i funksioneve motore ose ndjesore.)do të konsiderohet "*Paaftësi e Përhershme Totale*" .Paftësia e Përhereshme Totale për punë duhet të vërtetohet nga nje autoritet mjeksore kompetente
1.16 "*Certifikata e Sigurimit*" është certifikata e leshuar nga siguruesi ose ndërmjetësi i autorizuar nga Siguruesi, subjekt i kushteve të policës në grup, mbi bazën e detajeve të dakordësuara, e cila i lëshohet klientit huamarrës, si evidencë e pranimit të rrezikut, dhe përmban minimalisht të dhënat identifikuese të të siguruarit, afatin e fillimit dhe përfundimit të mbulimit, kushtet e përgjithshme të sigurimit dhe detaje të tjera të nevojshme sipas përcaktimeve të siguruesit.
1.17 "*Afati i policës*" i referohet afatit te Policës së sigurimit në grup, brenda të cilit janë lëshuar certifikatat e sigurimit për individët e siguruar të grupit (klientët e Policëmbajtësit). Gjithashtu referencat me afatin e polices nënkuptojnë dhe afatin e mbulimit të certifikatave të sigurimit.
1.18 "*Data e fillimit të rrezikut*" është data e fillimit të mbulimit për të siguruarin, e cila do të nënkuptojë datën e fillimit të mbulimit sipas certificatës, nëse kjo e fundit është lëshuar brenda periudhës së mbulimit të policës së sigurimit në grup. 1.19 "*Lista e të siguruarve*" është një regjistër i mbajtur nga Policëmbajtësi, i cili përmban informacione rreth të siguruarve, duke përfshirë por pa u kufizuar në numrin unik të certifikatës, datën e lëshimit, të dhënat personale, vlerën e huasë, monedhën që lëshohet certifikata, primin total, datën e fillimit dhe datën e mbarimit.
1.20 "Policëmbajtësi" nënkupton personin apo subjektin i cili është emëruar në policë.
1.21 "*Data e fillimit të policës"* data kur kjo policë sigurimi fillon efektet/hyn në fuqi, sipas afatit në skedulin e policës.
1.22 "*Data e lëshimit të policës*" nënkupton datën e lëshimit të policës në grup nga shoqëria e sigurimit.
1.23. "*Data e rinovimit të policës"* nënkupton të njejtën datë në fund të çdo viti nga data e lëshimit të policës në grup.
2. MBULIMI NË SIGURIM
Siguruesi do t'i paguajë policëmbajtësit/ përfituesit Përfitimin e Pagueshëm në rast të ndodhjes së ngjarjes së sigurimit. Në përputhje me përcaktimin në policën e sigurimit dhe në Kushtet e Përgjithëshme të sigurimit, ngjarje sigurimi do të jetë nje nga vijueset :
« *Humbja e Jetës* » ose
« *Humbja aksidentale e jetës* » ose
« *Humbja aksidentale e jetës dhe Paftësia e Përherëshme Totale si pasoje e aksidentit* »
3. DEBITORËT E SIGURUAR
3.1 Debitori do të quhet i siguruar kur polica e sigurimit hyn në fuqi.
3.2 Debitori është përgjegjës për shlyerjen e huasë ndaj Kreditorit.
3.3 Në këte kontratë sigurimi do të përfshihen debitorët që janë në kufijtë 18 deri në 65 vjec . Të siguruarit që arrijnë moshën kufi, kur kontrata e sigurimit është në fuqi mbeten të siguruar deri në përfundim të periudhës së sigurimit.
4. NJOFTIMET E TË SIGURUARIT DHE POLICËMBAJTËSIT
4.1 Deklarimet e të Siguruarit dhe të Policëmbajtësit duhet të jenë të sakta dhe të plota.
4.2 Policëmbajtësi duhet t'i ofrojë Siguruesit cdo informacion që ka lidhje me debitorët e siguruar. Në rast të ndodhjes së ngjarjes së sigurimit Policëmbajtësi duhet ti lejojë Siguruesit të inspektojë cdo material që ka lidhje me të Siguruarin.
4.3 Me lidhjen e kësaj kontrate sigurimi, I Siguruari lejon Siguruesin dhe autorizon çdo mjek, qendër shëndetesore, spitalore, që t'i japë ketij të fundit çdo informacion lidhur me historikun mjekësor të tij në rast të ndodhjes së ngjarjes së sigurimit. LËSHIMI I CERTIFIKATËS DHE HYRJA NË FUQI E SIGURIMIT
Certifikata e sigurimit do të lëshohet për të gjithë shumën e sigurimit. Polica e sigurimit është nënshkruar nga i Siguruari; Siguruesi ka lëshuar Certifikatën e Sigurimit ose ka dhënë me shkrim pëlqimin e tij.Në qoftë se Certifikata e Sigurimit parashikon nje date fillimi të mëvonshme, sigurimi nuk mund të hyjë në fuqi përpara orës 24.00 të ditës së caktuar. Certifikata e sigurimit do të lëshohet nje herë per të gjithë periudhën e kredisë.
6.TERRITORI I MBULIMIT
6.1 Rreziku i vdekjes është i mbuluar pa asnje kufizim territorial
7. PERFITIMI I DËMSHPËRBLIMIT
7.1 Në rast të vërtetimit të ngjarjes së sigurimit përpara përfundimit të Policës së sigurimit, Siguruesi detyrohet t'i paguajë Përfituesit /Policëmbajtësit përfitimin për sigurimin e jetës që është i barabartë me Përfitimin e Pagueshëm.
8. RREZIQE TË PËRJASHTUARA
8.1 Ky sigurim nuk mbulon vdekjen e të Siguruarit që është rrjedhojë direkte ose indirekte e:

- Pjesëmarrjes së të Siguruarit në veprimtari të paligjëshme apo kriminale, akte kriminale e këqedashëse nga persona me te cilët i Siguruari ka konflikte të mëparëshme, si dhe sulme apo veprime e kundërveprime të dhunshme të provokuara me të tretët, përvec kur i Siguruari vepron në kushtet e nevojës ekstreme për vetmbrojtje;
- Pjesëmarrjes së trashëgimtarëve ligjore, ortakëve ose përfituesit në akte kundër interesit të të Siguruarit, ose kryerja e sigurimit në rrethana të paramenduara që favorizojnë pagesën e dëmit.
- e luftës, pushtimit, akteve kriminale (pavarësisht nëse lufta është shpallur ose jo), luftra civile, revolucionit, rebelimit, sekuestrimit të personit, trazirave, krimit të organizuar, përdorimit të armëve ose paisjeve të luftës, akteve terroriste, agresionit.
- Praktikimit të sporteve të rrezikshme apo parashutizmi, ngjitjete malore, fluturimit me avion pa motor, zhytjeve nënujore, garave sportive motorrike apo drejtimi I mjeteve toksore, ujore apo ajrore pa licence.
- Udhëtimit të të siguruarit me cdo mjet fluturimi, përvec se, kur udhëton si pasagjer (dhe jo si anëtarë i ekuipazhit) në nje mjet fluturimi që është i autorizuar për transportin e pasagjereve.
- Aksidentit nga shpërthimet dhe radiacioni i energjisë bërthamore, përmbytjet, tërmetet, zhvendosjet e tokes dhe shpërthimet vullkanike;
- Vetëvrasjes dhe tentativës për vëtvrasje nëse ndodh në dy vitet e para te hyrjes ne fuqi të kontratës së sigurimit ose të riaktivizimit të mundshëm të sigurimit;
- Cdo lloj defekti fizik apo mendor preekzistues, sëmundjeve të njohura të trajtuara apo të diagnostikuara përpara marrjes në sigurim ose sëmundje të lidhura me to, përvecse kur

është deklaruar me shkrim nga i Siguruari dhe është pranuar shprehimisht me shkrim nga Siguruesi.

- Influenca dhe perdorimi I alkolit (dehja), drogës apo substancave të tjera narkotike, përdorimit me tepri të psikofarmaceutikëve, ilaceve apo halucinanteve,si dhe pasojave që rrjedhin prej tyre.

- Sëmundje veneriane, sëmundje seksualisht të trasmetueshme, sëmundje si pasojë e virusit HIV.

Në rast vdekje, Përfituesi nuk do të paguhet nëse kufoma nuk gjendet apo është e paidentifikueshme.

9. AFATET E PAGESËS SË PRIMIT DHE PASOJAT E MOSPAGIMIT:

Sigurimi hyn në fuqi me pagesën e primit. Primi i sigurimit paguhet paraprakisht si prim i vetëm për të gjithë kohëzgjatjen e periudhës së sigurimit. I siguruari detyrohet t'i paguajë siguruesit primin e sigurimit në afatet e caktuara në police. Nëse primi nuk paguhet brenda afatit kohor të përcaktuar në policën e sigurimit, atëhere mbulimi i dhënë përfundon prej fillimit (ab initio).

10. PËRFUNDIMI I MBULIMIT NË SIGURIM

10.1 Kontrata e sigurimit do të konsiderohet e përfunduar për të siguruarin në rast se ndodh nje nga ngjarjet e mëposhtme:

huaja është shlyer; huaja është transferuar tek nje Debitor tjetër jo i përfshire në këtë policë sigurimi; ka ndodhur ngjarja e sigurimit dhe primi i sigurimit nuk është paguar; Siguruesi i ka paguar Përfituesit shumën e dëmshperblimit; Primet nuk janë paguar brenda 15 ditëve nga afati i pagesës.

11.CEDIMI PENGU DHE BLLOKIMI

11.1 I siguruari nuk mund ta cedojë policën e sigurimit te një palë e tretë si garanci, ose nuk mund ta bllokojë shumën e sigurimit në emër të një personi të tretë.

12. PAGESAT E SIGURUESIT

12.1 Për të gjitha pagesat që Siguruesi do të kryejë duhet të dorëzohen paraprakisht dokumentet e mëposhtme:

certifikatë e lindjes së të siguruarit; polica origjinale e sigurimit; certifikatë e vdekjes së të siguruarit; Skeda e vdekjes ;raporti mjeksor për trajtimet në spital, diagnoza klinike dhe shkaku i vdekjes ;dokumentet që vërtetojnë shumën e dëmshpërblimit që Siguruesi detyrohet të paguajë; dokumente ligjore ose jo që mund të kërkohen nga Siguruesi

12.2 Nëse ndodh ngjarja e sigurimit Siguruesi detyrohet të paguajë brenda 30 ditëve nga momenti i marrjes së dokumentave të nevojshme.

12.3 Pagesat do të bëhen në llogarine e Policëmbajtësit/Përfituesit, nëse huaja është lëvruar. Nëse për ndonje arsye nuk është realizuar lëvrimi i huasë, detyrimi i Siguruesit është vetëm kthimi i primeve të sigurimit.

13. SUBROGIMI

Të gjitha të drejtat e Policëmbajtësit/përfituesit /të siguruarit ndaj cdo pale të tretë përgjegjëse për ngjarjen e sigurimit, do t'i kalojne Siguruesit, më pagesën e përfitimit ndaj Përfituesit/Poliëmbajtësit. Me kërkesën e Siguruesit, cdo kërkues përfitimi sipas kësaj policë sigurimi, do të ndërmarrë dhe do të lejoje të ndërmerren të gjitha masat e nevojshme për ushtrimin e të drejtave ndaj cdo pale të tretë në emër të të siguruarit para dhe/ose pas cdo pagese të kryer nga Siguruesi.

14. TAKSAT DHE TATIMET

14.1 Taksat dhe tatimet, nëse do të ekzistojnë do të jenë në ngarkim të të Siguruarit dhe Kreditorit.

15. DISPOZITA TË TJERA

15.1 Mosmarëveshjet që mund të lindin nga kjo kontratë, nëse nuk zgjidhen me mirëkuptim, do të zgjidhen në rrugë gjyqësore.

15.2 Për cka nuk është parashikuar në dispozitat e këtyre kushteve të përgjithshme do të zbatohen dispozitat e Kodit Civil.

DEKLARIME TË KLIENTIT PËR "SIGURIMIN E MBROJTJES SË KREDISË"

Për Kredi Konsumatore

1.1. Pasi u njoha nga IutePay shpk me produktet e sigurimit dhe shoqëritë e sigurimit me të cilat bashkëpunon në ofrimin e këtyre produkteve, me qëllim sigurimin e kredisë pranë IuteCredit Albania Sh.a., nëpërmjet kësaj kërkesë deklaroj me vullnetin tim të lirë dhe të plotë se pranoj që të kryej "Sigurimin e Mbrojtjes së Kredisë" pranë Siguruesit të zgjedhur si dhe u njoha me tarifën në link më poshtë:
https://iute.al/lista-e-cmimeve/lista-e-cmimeve-iutepay/

1.2. Deklaroj se jam njohur dhe jam plotësisht dakord me kushtet dhe afatet e paraqitura në Paketën e Sigurimit të Mbrojtjes së Kredisë. Në përputhje me përcaktimin në formularin e certifikatës së sigurimit dhe parashikimet e Kushteve të Përgjithshme të sigurimit, kuptoj dhe pranoj që «Ngjarja e Sigurimit" do të thote: "Humbja e jetës së të siguruarit për shkaqe aksidentale apo natyrore si dhe paaftësia e përhershme e plotë brenda periudhës së sigurimit, ndodhja e të cilës sjell detyrimin e Siguruesit për të paguar përfitimin sipas kushteve të kontratës.Përfitimi i pagueshëm do të jetë shuma e mbetur e huasë në datën e ndodhjes së ngjarjes së sigurimit.»

1.3. Deklaroj dhe bie dakord se në kuadër të sigurimit të mbrojtjes së kredisë, Përfituesi i sigurimit është "IuteCredit Albania Sh.a. dhe se çdo përfitim sipas sigurimit të mbrojtjes së kredisë do t'i paguhet IuteCredit Albania Sh.a.

1.4. Autorizoj IutePay shpk të pajisë Siguruesin e zgjedhur prej meje me të gjithë informacionin dhe dokumentacionin e nevojshëm për sigurimin që lidhet me Kredinë e marrë pranë IuteCredit Albania Sha. Ky autorizim jepet për një afat të pacaktuar dhe përfshin të drejtën e IutePay në cilësinë e agjentit, që të kryejë rinovimin e certifikatës së sigurimit, pa qenë nevoja për autorizim tjetër nga ana ime, për sa kohë që sigurimi lidhet me afatet e huasë. Për të revokuar këtë autorizim, detyrohem të njoftoj me shkrim IutePay, 30 ditë përpara përfundimit të afatit të certifikatës.

1.5. Jam njohur me Deklaratën e Privatësise të Siguruesit dhe autorizoj Siguruesin të mbledhë dhe përpunojë të dhënat dhe informacionin personal i cili nevojitet për administrimin e kontratës së sigurimit, për dhënien e shërbimeve ndaj të Siguruarit dhe Përfituesit përfshirë trajtimin e dëmit, për ofrimin e produkteve apo shërbimeve të reja, bazuar në legjislacionin përkatës të mbrojtjes së të dhënave personale (Ligii Nr. 9887, datë 10.03.2008, "Për mbrojtjen e të dhënave personale") si dhe transferimin e të dhënave personale tek të tretë për qëllime të sigurimit të cilët garantojnë gjithashtu mbrojtjen e të dhënave personale.

1.6. Jam i informuar që nuk ngarkohem me komisione shtesë për këto produkte sigurimi.

1.7. Jam informuar se në rast të mbylljes së parakohshme të kredisë, mbaron mbulimi me sigurim dhe primi i sigurimit nuk është i rimbursueshëm përvec se kur ushtroj të drejten e tërheqjes nga kredia brënda 14 ditësh nga marrja e saj.

**Shënim:**

*IutePay nuk këshillon apo rekomandon përzgjedhjen e shoqërive të sigurimit për produktet që ofrojnë. Ne mund t'ju bëjmë disa pyetje për të kuptuar kërkesën tuaj vetëm për qëllim të dhënies së informacionit mbi produktet e përzgjedhura nga klienti, por zgjedhja është tërësisht në vullnetin e lirë të klientit.*

*Lutem, lexoni me kujdes dokumentat dhe informacionin e vënë në dispozicion për t'u siguruar që zgjedhja i përshtatet nevojave tuaja.*

SEKSIONI B: INFORMACIONE TË PËRGJITHSHME TË SIGURIMIT TË MBROJTJES SË KREDISË

"SIGURUESI":, person juridik i regjistruar rregullisht pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit dhe licensuar si Shoqëri Sigurimi Jetë nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare.

IUTEPAYSHPK /AGJENTI

Adresa: Rruga "Andon Z. Cajupi", Pallati Nr.3, Hyrja Nr. 2, Kati Nr.3, Tiranë

MBULIMI NE SIGURIM

Siguruesi do t'i paguajë policëmbajtesit/ përfituesit Përfitimin e Pagueshëm në rast tëndodhjessëngjarjessësigurimit.

NëpërputhjemepërcaktiminnëcertifikatënesigurimitdhenëKushtetePërgjithshme tësigurimit,ngjarjesigurimidotëjetënjë ngavijueset:

- «HumbjaeJetës»ose/«Humbjaaksidentaleejetës»ose/
- «PaaftësiaePërhershmeTotalesipasojëeaksidentit»

**'HumbjaeJetësose Humbja Aksidentale e Jetës'**dotëquhetHumbjaejetëssëtësiguruaritbrëndaperiudhës së sigurimit.
**'Paaftësia e Plotë e Përhershme si rrjedhojë e një aksidenti'** është paaftësia e shkaktuar nga një aksident, i cili ndodh brënda periudhës së sigurimit, që e ndalon plotësisht të siguruarin për t'u marrë me cdo veprimtari ekonomike ose punë të cdo l loji dhe që pas përfundimit të një periudhe 52 javore nga fillimi i paaftësisë si pasojë e një aksidenti rezulton:

- Humbja totale dhee paripariueshmeeshikimitnëtëdysytë;
- humbjatotalefizikeosefunksionaleedyosemëshumëgjymtyrëvesëbashku;
- humbja e plotë e shikimit në një sy dhe humbja e një gjymtyre së bashku;
- paraliza eplotë (Humbjaosedëmtimiifunksionevemotore dhendjesore.)

'Paaftësi e Plotë e Përhershme' për pune si me sipër duhet të vërtetohet nga një autoritet mjekësor kompetent.
'Aksident'. Një ngjarje e papritur dhe e paparashikuar që ndodh pa vullnetin e të siguruarit, e identifikueshme për sa i përket kohës dhe vendit të ndodhjes, që ka impakt trupor të drejtpërdrejtë të jashtëm dhe të dhunshëm mbi të siguruarin.
'Humbja Aksidentale e Jetës'. Humbja e jetës të të siguruarit si rrjedhojë e një Aksidenti që ndodh brenda periudhës të sigurimit, humbje jete që ndodh brenda 12 muajsh ngadata e këtijAksidenti.

TERRITORI I MBULIMIT

Rreziku i Humbjes së Jetës është i mbuluar pa asnjë kufizim territorial , ndërsa rreziku i aksidenteve pa pasojë Humbjen e jetës, është i mbuluar vetëm brënda territorit të Rëpublikës së Shqipërisë.

RREZIQE TË PERJASHTUARA

Ky sigurim nuk mbulon vdekjen e të Siguruarit që është rrjedhojë direkte ose indirekte e pjesëmarrjes së të Siguruarit në veprimtari të paligjshme apo kriminale, akte kriminale e keqdashëse nga persona me të cilët i Siguruari ka konflikte të mëparshme, si dhe sulme apo veprime e kundërveprime të dhunshme të provokuara me të tretët, përvec kur i Siguruari vepron në kushtet e nevojës ekstreme për vetëmbrojtje, pjesëmarrjes së trashëgimtarëve ligjore, ortakëve ose përfituesit në akte kundër interesit të të Siguruarit, ose kryerja e sigurimit në rrethana të paramenduara që favorizojnë pagesën e dëmit, luftës, pushtimit, akteve kriminale (pavarësisht nëse lufta është shpallur ose jo), luftra civile, revolucionit, rebelimit, sekuestrimit të personit, trazirave, krimit të organizuar, përdorimit të armëve ose paisjeve të luftës, akteve terroriste, agresionit, praktikimit të sporteve të rrezikshme apo parashutizmi, ngjitjeve malore, fluturimit me avion pa motor, zhytjeve nënujore, garave sportive motorrike apo drejtimi i mjeteve tokësore, ujore apo ajrore pa licencë.

Udhëtimit të të siguruarit me cdo mjet fluturimi, përvec se, kur udhëton si pasagjer(dhe jo si anëtar i ekuipazhit) në një mjet fluturimi që është i autorizuar për transportin e pasagjerëve; aksidentit nga shpërthimet dhe radiacioni i energjisëbërthamore, përmbytjet, tërmetet, zhvendosjet e tokës dhe shpërthimet vullkanike;vetëvrasjes dhe tentativës për vetëvrasje nëse ndodh në dy vitet e para të hyrjes në fuqitëkontratessësigurimitosetëriaktivizimittëmundshëmtë sigurimit;

Cdo lloj defekti fizik apo mendor parekzistues, sëmundjeve të njohura të trajtuara apo të diagnostikuara përpara marrjes në sigurim ose sëmundje të lidhura me to, përvecse kur është deklaruar me shkrim nga i Siguruari dhe është pranuar shprehimisht me shkrim nga Siguruesi; Influenca dhe përdorimi i alkoolit (dehja), drogës apo substancave të tjera narkotike, përdorimit me tepri të psikofarmaceutikeve, ilaceve apo halucinanteve, si dhe pasojave që rrjedhin prej tyre. Sëmundje veneriane, sëmundje seksualisht të trasmetueshme, sëmundje si pasoje e virusit HIV. Në rast vdekje, Përfituesi nuk do të paguhet nëse kufoma nuk gjendetapoështëepaidentifikueshme.

**Individë që nuk sigurohen**
Siguruesi nuk ofron mbulimnësigurimpër:

- individë që vuajnë nga alkoolizmi, narkotizmi, sëmundje mendore, paranoia, sindroma organiko-cerebrale;
- individë që kanë nevojë për kujdes të përhershëm;
- individë mbi 65 vjeç;
- individë më të rinj se 18 vjeç HAPJAE

PRAKTIKAVE TË DEMEVE

Njoftimi i rastit të ngjarjes së sigurimit bëhet sipas formularit përkatës:

✓ meshkresënëadresënzytaretëShoqërisësëSigurimit

- ✓ nëmënyreelektronikenëemail-inzyrtartëShoqërisësëSigurimit

Praktika e dëmit hapet në momentin e njoftimit të rastit të sigurimit nga:

- ✓ policëmbajtësi,
- ✓ përfituesi,apo
- ✓ i siguruari.

AFATI I SHQYRTIMIT TE PRAKTIKËS SË DËMIT

Praktika e dëmit shqyrtohet brenda 30 ditëve nga data e dorëzimit të dokumentit të fundit nga Përfituesi ,apoi Siguruari.
Ky afat shtyhet deri në dorëzimin e dokumentit shtesë të fundit të kërkuar nga shoqëria e sigurimit;
Periudha e trajtimit të rastit të sigurimit do të jetë e ndryshme nëse kjo gjë është parashikuar në kushtet e kontratës së sigurimit.
Afati i shqyrtimit te praktikës shtyhet deri në vërtetimin e shkaqeve apo nxjerrjes sepaaftësisëpërrastete:

- ✓ e paaftësisë së përhershme, kur nuk është e mundur të përcaktohet brenda një kohe të shkurtër shkalla e paaftësisë;
- ✓ vdekjes, kur rrethanat e ndodhjes së dëmit janë të paqarta dhe kërkojnë një periudhë të gjatë për tu vërtetuar nga organet kompetente.

DOKUMENTACIONI I NEVOJSHËM PËR PLOTËSIMIN E PRAKTIKAVE TË DËMEVE

Njoftimi irastit të sigurimit sipas formularitpërkatës.

- CertifikataeSigurimitosecertifikataesigurimit
- Skedaevdekjesdhecertifikataevdekjes(kurisiguruarikahumburjeten
- Dokumentacioni mjekësor (epikriza mjeksore, kopje te karteles mjekesore, etj) sipas rastit të sigurimit që mbulon certifikata e sigurimit;
- Dokumentacioni nga organet e policisë dhe ato të drejtësisë (gjykatë;prokurori)sipas rastittë sigurimit;
- Fletë-Drejtimi për në KEMP dhe Vendimin e Komisionit të caktimit të paaftesisë në punë KMCAP (për rastet e paaftesisë së plotë të përhershme nga Aksidenti).
- Çdo dokument tjetër sipas certifikatës së sigurimit dhe të kërkuar nga shoqëria e sigurimit.

Për më tepër në lidhje me procedurën në rast dëmi, informacioni gjendet në faqenzyrtaretështhoqërisesësigurimit të përzgjedhur nga i siguruari.

ANKESA:

Për cdo ankesë lidhur me procesin e sigurimit mund të drejtoheni në faqen zyrtare të shoqërisë së sigurimit përzgjedhur nga ju, sipas mënyrave të kontaktit të publikuara në faqen ANKESA.

Në rast se keni pyetje apo paqartësi të tjera, Iutepay shpk mund t'ju vijë në ndihmë duke kontaktuar sipas mënyrave të kontaktit: https://iute.al/kontakt/

PËRFUNDIMI I KONTRATËS SË SIGURIMIT

Kontrata e sigurimit do të konsiderohet e përfunduar në rast se ndodh një nga ngjarjet e mëposhtme: a) huaja është shlyer; b) huaja është transferuar tek një Kredimarres tjetërjoipërfshirënëkëtëcertifikatësigurimi; c)kandodhurngjarjaesigurimitdheprimiisigurimit nuk është paguar; d) Siguruesi i ka paguar Përfituesit shumën e dëmshpërblimit;

CEDIMI, PENGU, BLLOKIMI DHE LËSHIMI I DUBLIKATËS

I siguruari nuk mund ta çedojë çertifikatën e sigurimit të një palë e tretë si garanci, ose nuk mundta bllokojështhumënesigurimitnëemër tënjëpersonitë tretë.

